



Periodiku AMF

Llogaritja e primit MTPL nga Komiteti i Aktuarëve

Në bazë të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores nr. 75, datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, përlllogaritja e tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm është detyrë e Komitetit të Aktuarëve.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - tetor 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - tetor 2010 arritën shifrën 6,795,205 mijë lekë, përkundrejt 6,684,806 mijë lekë të realizuara në janar - tetor 2009 ose 1.65% më shumë.

Vijon në faqen 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari ndërkombëtar mbi mbështetjen e stabilitetit financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (FSA) i Britanisë së Madhe, zhvilloi gjatë periudhës 29 nëntor - 2 dhjetor 2010, në Londër, Angli, seminarin ndërkombëtar 2010 me temë “Mbështetja e stabilitetit financiar”.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet konferenca e 5-të dyvjeçare “Menaxhimi i Riskut dhe Mbikëqyrja”

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) zhvilluan në 3-4 nëntor në Basel, Zvicër, konferencën e 5-të dyvjeçare me temë “Menaxhimi i Riskut dhe Mbikëqyrja”.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari mbi parandalimin dhe menaxhimin e krizave në tregun e sigurimeve, mësimet e marra nga krizat financiare

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilloi gjatë periudhës 9-11 nëntor, në Basel, Zvicër, seminarin mbi parandalimin dhe menaxhimin e krizave në tregun e sigurimeve, mësimet e marra nga kriza financiare.

Vijon në faqen 6

Zhvillohet seminari mbi zbatimin e parimeve të IOSCO-s për emetuesit, i skemave të investimeve kolektive dhe zbatueshmëria

Shoqata e Letrave me Vlerë të Japonisë, Autoriteti Rregullator Financiar i SHBA-së (FINRA) dhe organizatat vetërregulluese të Brazilit, zhvilluan gjatë periudhës 29 nëntor-3 dhjetor 2010, në Rio de Janero, Brazil seminarin mbi zbatimin e parimeve të IOSCO-s për emetuesit, i skemave të investimeve kolektive dhe zbatueshmëria.

Vijon në faqen 7

Edukimi i konsumatorit

Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

2. Mekanizma të tjerë të mbajtjes në kontroll

Mirëpo, këto instrumente të transparencës dhe edukimit shumë rrallë mjaftojnë të vetme edhe atëherë kur përdoren në periudhën afatgjatë për të siguruar një treg pensionesh, i cili funksionon mirë.

Vijon në faqen 9

Në këtë numër:

Llogaritja e primit MTPL nga Komiteti i Aktuarëve	2
Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura	3
Ngjarje dhe zhvillime të tjera	5
Edukimi i konsumatorit	9

Llogaritja e primit MTPL nga Komiteti i Aktuarëve

Në bazë të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores nr. 75, datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, përlllogaritja e tarifave të primeve të sigurimit të detyrueshëm është detyrë e Komitetit të Aktuarëve. Ky komitet është i përbërë nga 9 anëtarë me nga një përfaqësues për çdo kompani dhe një përfaqësues i AMF-së.

Komiteti llogarit primin e rrezikut mbi bazën e të dhënave statistikore të tregut në vite.

Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut me ngarkesën mbi primin e rrezikut. Ngarkesa mbi primin e rrezikut përcaktohet nga shoqëria e sigurimit. Në zbatim të Rregullores nr. 75, datë 28.08.2009 “Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 8, pika 4, niveli i ngarkesës mbi primin e rrezikut nuk duhet të kalojë masën 25% të primit të sigurimit.

Analiza aktuariale e tarifave të sigurimit MTPL është bazuar pjesërisht në eksperiencën e dëmeve të ndodhura në periudha të mëparshme. Eksperienca e dëmeve në të ardhmen mund të ketë ndryshime substanciale ndaj asaj të viteve të shqyrtuara. Në vlerësimet aktuariale të elementëve në përlllogaritjet për primin e pastër, Komiteti i Aktuarëve është përpjekur të konsiderojë toleranca të arsyeshme lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të dëmeve, të cilët nuk do të zhvillohen pikë për pikë sipas projektimit, si dhe mund të ndryshojnë në mënyrë të dukshme nga projektimi.

Nga eksperienca e deritanishme në përlllogaritjet për tarifën e sigurimit MTPL nuk vihen re ndryshime thelbësore. Lidhur me këtë, duke pasur në konsideratë që përmirësimet dhe standardizimet në vlerësimin e dëmeve prej ekspertëve të pavarur do shoqërohen me rritje të

raportit dëme/prime, është e nevojshme të përlllogaritet edhe një element shtesë në elementet e rrezikut, të përfshira në metodikën e përzgjedhur nga Komiteti i Aktuarëve.

Teknikat statistikore që janë përdorur në analizën e eksperiencës së dëmeve bazohen në supozime matematikore, të cilat nuk shkojnë saktësisht sipas eksperiencës reale. Gjithmonë paraqitet pasiguri në vlerësimin e eksperiencës së ardhshme të dëmeve në klasat e sigurimit të jetës. Në mënyrë të veçantë, në vlerësimin e provigjoneve teknike të dëmeve, është e nevojshme të projektohen dëmet, si dhe shpenzimet për trajtimin e dëmeve. Asnjë prej këtyre dy elementeve nuk zhvillohet në përpikmëri me projektimin, për më tepër mund edhe të ndryshojë në mënyrë të dukshme nga projektimet. Më tej, në pjesën më të madhe të klasave të sigurimit, fusha e zhvillimeve të pafavorshme tejkalon fushën e zhvillimeve të favorshme. Në mënyrë të veçantë, megjithëse është cilësuar përdorimi i tolerancave sa me të arsyeshme lidhur me monitorimin e rregullt të trajtimit dhe vlerësimit të dëmeve, nuk është parashikuar emergjenca e tipeve të rinj të dëmeve.

Thelbi i metodologjisë së përdorur për ndërtimin e tarifave të sigurimit MTPL konsiston në:

- përdorimin e të dhënave lidhur me frekuencën e dëmeve dhe dëmin mesatar në vitet paraardhëse në ndërtimin e tarifave të reja;
- axhustimin e të dhënave, duke konsideruar tendencën e zhvillimit të tyre në të ardhmen, bazuar si në rritjen e njohurive të publikut për të drejtën e kërkesës dhe ankimit për një ngjarje të sigurimit, si dhe me tendencën e rritjes së inflacionit e dëmeve të paguara prej fondit të kompensimit.

Efektet e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe Rregullores nr. 53,

datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit” kanë filluar të reflektohen gjatë vitit 2010. Për këtë arsye, është vendosur që të shqyrtohen të dhënat e 9 mujorit të vitit 2010, për të pasur një pasqyrë sa më reale të ecurisë së dëmeve, gjë që do të reflektohet në primin e riskut dhe si rrjedhim në tarifën e primeve.

Përsa i përket tarifave të sigurimit kufitar, duke konsideruar faktin që raporti dëme/prime është tepër i ulët, rreth 8%, është menduar të mbeten në fuqi të njëjtat tarifa.




Gjithashtu, është propozuar unifikimi i kategorive të policës kufitare me ato të kartonit jeshil, pra kategoria E e policës kufitare të ndahet në 3 të tilla, E1, E2 dhe E3.

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - tetor 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - tetor 2010 arritën shifrën 6,795,205 mijë lekë, përkundrejt 6,684,806 mijë lekë të realizuara në janar - tetor 2009 ose 1.65% më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47.09% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.91% të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 10.21% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 1.29% të sigurimeve të Jo-Jetës. 89.72% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 9.63% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës dhe 0.65% nga veprimtaria risigurimi.

Gjatë periudhës janar - tetor 2010 u nënshkruan rreth 567,101 kontrata sigurimi, ose rreth 11.60% më pak se në janar - tetor të vitit 2009.



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-tetor (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Janar - Tetor	2009	2010
A) Sigurim i Jetës	593,577	654,199
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,019,170	6,096,914
a) Sigurimi Detyrueshëm	3,618,641	3,595,369
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,400,530	2,501,544
c) Risigurimi	72,059	44,093
TOTAL	6,684,806	6,795,205

Sigurimet e detyrueshme

Gjatë janar - tetor 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 52.91% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar - tetor 2010, arritën 2,514,025 mijë lekë, ose 7.86% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Në janar - tetor 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 726,115 mijë lekë, ose rreth 23.78% më pak se në janar - tetor 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar - tetor 2010 arritën në 355,229 mijë lekë, apo 6.01% më shumë se në janar - tetor 2009.

Sigurimet vullnetare

Në janar - tetor 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,199,836 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 4.36% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura



2,545,637 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 33.11% të pasuara nga, sigurimi kasko me 19.59% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 17.50% peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - tetor 2010, arritën në 315,946 mijë lekë, 1.78% më pak se në janar - tetor 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 77.49% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e Jetës në janar - tetor 2010 arritën në rreth 654,199 mijë lekë, ose rreth 10.21% më shumë se në janar - tetor 2009. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredithënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, InterAlbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 31.54% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.70% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - tetor 2010 kapi vlerën 1,792,681 mijë lekë, ose 29.28% më shumë se në janar - tetor 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,556,420 mijë lekë, apo 86.82% të totalit.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet seminari ndërkombëtar mbi mbështetjen e stabilitetit financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (FSA) i Britanisë së Madhe, zhvilloi gjatë periudhës 29 nëntor - 2 dhjetor 2010, në Londër, Angli, seminarin ndërkombëtar 2010 me temë “Mbështetja e stabilitetit financiar”.

Çështjet kryesore për diskutim u mbuluan nga një numër prezantimesh të mbajtura nga ekspertë të nivelit të lartë të FSA-së. Ndër prezantimet kryesore, përmendim: *zhvillimet ndërkombëtare në rregullimin e shërbimeve financiare, përgatitjen e mbikëqyrësve për sfidat e periudhës së paskrizës, parimet e menaxhimit të riskut, riskun dhe produktet e sektorit të sigurimeve, filozofinë e mbikëqyrjes në sektorin e sigurimeve dhe mbrojtjen e konsumatorit.*

Gjatë seminarit e theksua se kriza ekonomike vuri në diskutim kredibilitetin e rregullimit ligjor të tregjeve financiare, duke shkaktuar edhe zhvillime të reja në rregullimin e shërbimeve financiare nga FSA në veçanti. U prezantuan reformat rregullative në UK (Qeveria e UK ka vendosur që FSA të ndajë/veçojë aktivitetet e saj në 2012 sipas një strukture të re) dhe në Evropë (autoritetet e mbikëqyrjes evropiane do të zëvendësojnë komitetet ekzistuese si CEBS, CEIOPS dhe CESR respektivisht me EBA, EIOPA dhe ESMA). Gjatë prezantimit të axhendës së aktiviteteve ndërkombëtare të FSA-së, u theksua se marrëveshjet në nivel global i shërbejnë masave për ngritjen dhe mbajtjen e stabilitetit financiar.

Në prezantimin e temave që lidhen me filozofinë e mbikëqyrjes me bazë risku, u theksuan politikat e FSA-së në lidhje me menaxhimin e riskut. Këto politika konsistonin në: *integrimin e të gjitha risqeve, pavarësisht origjinës së tyre; kalibrimin e modeleve të riskut sipas madhësisë së riskut që mund të mbajë çdo shoqëri dhe mbështetja në*

parimet e menaxhimit të riskut. Gjithë këto politika mbështeten edhe në parimet e biznesit të sigurimeve, të cilat janë të rregulluara në ligjin anglez të sigurimeve.

Solvency II u prezantua si programi më i madh i ndërmarrë nga FSA, i cili do të respektojë afatin e vendosur (2012) për zbatim. Gjatë këtij prezantimi u paraqitën çështjet lidhur me Sloveny II (regjimet e ndryshme në Evropë, qeverisja e shoqërive, mbikëqyrja e grupeve, sensitiviteti ndaj riskut në llogaritjen e kapitalit), si dhe parimet kryesore të Sloveny II (pasqyrat financiare me çmimet e tregut, kapitali me bazë risku, qeverisja e shoqërive, vlerësimi mbikëqyrës).

Gjatë prezantimit të metodologjisë së mbikëqyrjes në FSA, u trajtua ndarja e punës brenda sektorit të mbikëqyrjes dhe në mënyrë të veçantë procesit të vlerësimit të riskut. Ky i fundit shihej i ndarë në: rishikimin e të dhënave dhe gjetjeve nga analiza në FSA, inspektim në vend gjatë të cilit i jepej shoqërisë një vlerësim për probabilitetin e riskut që ka kjo shoqëri në treg dhe një program të zbutjes së riskut që i prezantohej shoqërisë, i shoqëruar me një afat të përcaktuar. Shoqëritë, të cilat vlerësoheshin me risk të lartë, bëheshin më tej subjekt i një mbikëqyrje nga afër. Grupi mbikëqyrës i FSA-së, gjatë vlerësimit të riskut, u përqendrua në: mjaftueshmërinë e burimeve, planifikimin strategjik, menaxhimin e riskut nga shoqëria, qeverisjen e shoqërisë, trajtimin e drejtë të klientëve, funksionet e kontrollit dhe krimin financiar.

Në seminar merrnin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore.

Zhvillohet konferenca e 5-të dyvjeçare “Menaxhimi i Riskut dhe Mbikëqyrja”

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) zhvilluan në 3-4 nëntor në

Basel, Zvicër, konferencën e 5-të dyvjeçare me temë “Menaxhimi i Riskut dhe Mbikëqyrja”. Gjatë konferencës, e cila ishte e hapur për mbikëqyrjen dhe rregullatorët në sektorin e bankave, letrave me vlerë dhe sigurimeve, pati diskutime nga lektorë të autoriteteve të ndryshme të Evropës dhe Azisë, si dhe nga shoqëri sigurimi dhe banka prestigjioze.

Ndër temat kryesore mbi të cilat u zhvillua konferenca përmendim:

- strategjitë dhe sfidat në menaxhimin e riskut;
- zhvillimet e fundit në mbikëqyrje;
- fuqizimi i stabilitetit financiar.

Seancat e konferencës u përqendruan në:

- mendimin strategjik dhe risitë në menaxhimin global të rrezikut;
- Basel III dhe menaxhimi i rrezikut në institucionet financiare.

Gjatë seancave, lektorët diskutuan mbi probleme të ndryshme të institucioneve financiare, si: *vlerësimin e produkteve financiare të strukturuar, menaxhimin e tregut të likuiditeteve, modelet e rrezikut, aspektet e garantimit të kolateraleve dhe strukturat stimuluese përkatëse.*

Çështjet kryesore, përsa i përket mbikëqyrjes post-krize ishin: *roli i menaxhimit të rrezikut dhe të modelimit sasior në paketën e reformave Basel, çështje të qeverisjes dhe të nxitjes të strukturave financiare, roli i kapitalit, rreziku sistematik dhe stabiliteti financiar.*

Konferenca ishte e dobishme për një përditësim të mëtejshëm dhe shkëmbim eksperience në menaxhimin e rrezikut, si dhe në trajtimin e dy argumenteve të rëndësishëm, që konsiderohen gjithashtu pika kyçe dhe në mbikëqyrjen tonë, siç janë menaxhimi i bilancit dhe kapitalit, si dhe toleranca e rrezikut në një mjedis të paqëndrueshëm.

Zhvillohet seminari mbi parandalimin dhe menaxhimin e krizave në tregun e sigurimeve, mësimet e marra nga krizat financiare



Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilloi gjatë periudhës 9-11 nëntor, në Basel, Zvicër, seminarin mbi parandalimin dhe menaxhimin e krizave në tregun e sigurimeve, mësimet e marra nga kriza financiare.

Gjatë ditës së parë u diskutuan situata të ndryshme të krizave financiare dhe rasteve të falimentimit të kompanive në tregun e sigurimeve, si dhe u nënvizua nevoja për një sistem financiar më të qëndrueshëm ndaj këtyre luhatjeve, sistem që do të mbronte ekonominë.

Rekomandimet dhënë nga përfaqësuesit e Bordit të Stabilitetit Financiar (FSB) dhe nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) theksuan rëndësinë e konsolidimit të mbikëqyrjes, duke aplikuar mbikëqyrjen me fokus makro, si dhe mbikëqyrjen e grupit si një metodologji që do të reduktonte efektet e krizave të ardhshme nëpërmjet ndjekjes në avancë të tipareve të paqëndrueshmërisë financiare. Kështu, u prezantua një nga nismat e IAIS-it që synon mbikëqyrjen me 'makro-fokus'. Kuadri i përbashkët i mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve aktive në nivel ndërkombëtar, është një metodologji për mbikëqyrjen e integruar të grupeve të sigurimit aktive në nivel ndërkombëtar dhe ka për qëllim adresimin e aktiviteteve kryesore të grupit, rreziqet që lidhen me to, si dhe synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve të vendeve të ndryshme ku operon grupi. Kuadri i përbashkët i mbikëqyrjes së grupeve të sigurimeve aktive në nivel ndërkombëtar, do të përgatitet përgjatë tre viteve e do të jetë shumë specifike po jo rule-based.

U trajtuan gjithashtu, raste të ndryshme studimore të falimentimit të kompanive të sigurimit. U analizua rasti i falimentit të kompanisë të dytë më të madhe të sigurimit në Australi, kompanisë 'HIH', konsideruar falimenti më i madh në historinë e Australisë. Ndonëse kompanitë e sigurimit u prekën nga kriza financiare përgjithësisht në 'anën e aktivitetit ose të

investimeve' (shkaktuar nga rënia e çmimit të aksioneve dhe bonove korporative) faktorë të tjerë lidhen me krizat. Ndër më të rëndësishmit u përmendën politikat e nën-çmimit (underpricing), ulja e rezervave (under-provisioning), transaksionet midis grupit, marrëveshjet e veçanta të risigurimeve, mungesa e pavarësisë në qeverisje, mungesa e pavarësisë së auditit të jashtëm dhe përdorimi i metodave agresive të kontabilitetit.

Gjatë ditës së dytë u diskutua mbi masat e ndryshme që mund të ndërmerren për parandalimin e një krize të mundshme financiare ndërmjet të cilave përmendim: ndryshimi i profilit të riskut nëpërmjet ndryshimit të strategjisë së investimeve, politikës së marrjes në sigurim (si selektimi më i mirë i rreziqeve që kompania siguron), mbulimi me risigurim për dëme të ndodhura, ndalimi i transaksioneve huadhënëse në grup, shtimi i kapitalit që do të përdoret në periudhë vështirësie dhe kapitali shtesë për ngjarje të paparashikuara. Nga pjesëmarrësit u diskutua gjithashtu, mbi mjetet e mundshme për menaxhimin e rrezikut duke përmendur këtu analizën e skenarëve.

Rekomandimet nga përfaqësues të IAIS dhe FSB nënvizuan rëndësinë e krijimit të kolegjeve të mbikëqyrjes, si një mënyrë për përmirësimin e menaxhimit të rrezikut dhe forcimit të mbikëqyrjes së grupit. Mbikëqyrja e një grupi kërkon komunikim dhe bashkëpunim midis mbikëqyrësve të enteve të veçantë rregullatorë ku operon grupi.

Seminari u zhvillua nëpërmjet një tryeze të rrumbullakët që synonte diskutimet në grup dhe shkëmbimin e eksperiencave e në përfundim të tij u shpërndanë certifikata për tërë pjesëmarrësit.

Zhvillohet seminari mbi zbatimin e parimeve të IOSCO-s për emetuesit, i skemave të investimeve kolektive dhe zbatueshmëria

Shoqata e Letrave me Vlerë të Japonisë, Autoriteti Rregullator Financiar i SHBA-së (FINRA) dhe organizatat vetërregulluese të Brazilit, zhvilluan gjatë periudhës 29 nëntor-3 dhjetor 2010, në Rio de Janero, Brazil seminarin mbi zbatimin e parimeve të IOSCO-s për emetuesit, i skemave të investimeve kolektive dhe zbatueshmëria.

Gjatë ditës së parë u diskutua mbi kontributin e IOSCO-s në G20 dhe vlerësimin e bërë për të në samitin e Toronto-s. U përmendën direktivat për vitet 2010-2015 dhe synimet strategjike të IOSCO-s. Më pas çështjet e trajtuara në seminar lidheshin kryesisht me parimet e IOSCO-s, zbatimin e tyre në vendet përkatëse në kuadrin e zhvillimeve të reja botërore dhe krizës së përgjithshme financiare.

Ndër çështjet kryesore, përmendim:

- Parimet 16, 17 dhe 18 të IOSCO-s për emetuesit: - në diskutimet u theksua se mbajtësit e titujve në një kompani duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Duhet të ketë një transparencë të plotë, të saktë dhe në kohë të rezultateve financiare, riskut dhe informacioneve të tjera të rëndësishme për vendimet e investitorëve. Standardet e kontabilitetit të përdorura nga emetuesit, duhet të jenë të një cilësie të lartë ndërkombëtare të pranueshme.
- Parimet 24, 25, 26, 27 dhe 28 për skemat e investimeve kolektive - (CIS).

Në këtë panel u theksua se sistemi rregullator juridik duhet të parashikojë rregulla të qarta për strukturën e skemave të investimeve kolektive, ndarja veçantë dhe mbrojtja e aseteve të klientit. Objektivi i panelit ishte: të promovojë një panel krahasues për kuadrin rregullator të aplikuar për CIS në juridiksione të ndryshme. Sistemi rregullator duhet të vendosë standarde për pavarësinë, qeverisjen, organizimin dhe udhëheqjen operative të atyre që dëshirojnë të tregtojnë ose të drejtojnë një skemë kolektive

investimi. Rregullorja duhet të ketë të theksuar dhënien e informacioneve shpjeguese, të nevojshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e një skeme të investimeve kolektive për një investitor të caktuar dhe vlerën e interesit të investitorëve në skemë.

- Parimet 10, 11 dhe 12 për zbatimin e rregullores së Letrave me Vlerë.

Nëpërmjet diskutimeve u theksua se sistemi rregullator duhet të sigurojë një përdorim efektiv dhe të besueshëm të inspektimit, investigimit dhe fuqisë së mbikëqyrjes, si dhe të zbatimit të një programi efektiv. Rregullatori duhet të ketë kompetenca të plota të inspektimit dhe mbikëqyrjes. Ndërkohë dhe legjislacioni e zbatimi i tij nga rregullatori duhet të jetë të mjaftueshëm për të siguruar që ai mund të jetë efektiv edhe në rastet e administrimit të keq ndërkufitar. Rregullatorët e letrave me vlerë duhet të kenë legjislacionin e brendshëm të mjaftueshëm për t'u përballur me rreziqet e pastrimit të parave. Rregullatori duhet të kërkojë që ndërmjetësit e tregut të kenë në vend politikatat dhe procedurat e duhura për të minimizuar rrezikun e përdorimit të biznesit si një mjet për pastrimin e parave.

Nisur nga zhvillimet e globalizimit, progresit në teknologjinë e informacionit dhe diversitetin e metodave të tregtisë në tregjet e letrave me vlerë, sot këto të fundit përballen me shume sfida dhe ndryshime. Në shumë tregje të letrave me vlerë në botë kanë ndodhur ndryshime radikale në infrastrukturë dhe veçanërisht në sistemet e këmbimit midis vendeve. Aktivitetet globale të biznesit nuk janë më një praktikë e panjohur në ditët e sotme.

Zhvillimi i këtij seminari solli aspekte të reja për rishikimin e edicionit të 2008-ës të parimeve të IOSCO-s i plotësuar edhe me një metodologji të vlerësimit nga IOSCO. Janë shtuar tetë parime të reja, ndërkohë që të tjera janë amenduar apo hequr. Metodologjia e re është aktualisht në ndërtim nga një Task Force e IOSCO-s.

Edukimi i konsumatorit

Administrimi dhe mbikëqyrja e risqeve në sistemet e pensioneve me kontribute të përcaktuara

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve (IOPS) tetor 2010)

Vijon nga numri i kaluar...

2. Mekanizma të tjerë të mbajtjes në kontroll

32. Mirëpo, këto instrumente të transparencës dhe edukimit shumë rrallë mjaftojnë të vetme edhe atëherë kur përdoren në periudhën afatgjatë për të siguruar një treg pensionesh, i cili funksionon mirë. Duke pasur parasysh mungesën e njohurive dhe dijeve të individëve (duke përfshirë edhe një shkallë të madhe apatie kur bëhet fjalë për të marrë vendime të lidhura me pensionet), kompleksitetin e produkteve të pensioneve dhe çështjeve të mosfunksionimit të tregut (siç është asimetria e informacionit), konkurrenca brendapërbrenda tregjeve të pensioneve nuk ecën gjithmonë me sukses. Për rrjedhojë, mbikëqyrësit e pensioneve me kontribute të përcaktuara normalisht i përziejnë ato me mekanizmat e tjera të kontrollit.

33. Në këtë pjesë të materialit do të shohim tani mekanizmat e ndryshme të kontrollit që përdorin anëtarët e IOPS-së për të mbajtur nën kontroll rreziqet kryesore të cilat i kemi përshkruar më lart (paragrafi 17).

a. Risku i investimit

34. Risku më i rëndësishëm që mbajnë anëtarët e veçantë të fondeve me kontribute të përcaktuara është risku i investimit, sidomos nëse ofruesi i pensioneve nuk ofron asnjë formë garancie; pra, ky risk është në qendër të vëmendjes për shumicën e autoriteteve mbikëqyrëse. Norma e kthimit është përcaktori parësor i tepricës që do të akumulojë fondi i tyre dhe që do të përdorin më pas individët për të mbuluar shpenzimet e

jetës kur të dalin në pension. Nëse ky kthim është tepër i ulët (apo, edhe negativ) individët mund të përfundojnë në një situatë ku të kenë një tepricë tepër të vogël në fond në momentin e daljes në pension, e cila nuk do t'u siguronte të ardhura të mjaftueshme.

35. Sikurse e kemi thënë, kjo bëhet edhe më e vështirë kur në sistemet me kontribute të përcaktuara futet mundësia e bërjes së një zgjedhjeje nga individët. Sikurse e theksojnë edhe Impavido e të tjerë (2009): *“Ka prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se, edhe në kohëra normale, individëve në përgjithësi u mungojnë zotësitë për të monitoruar menaxhimin e portofolit dhe, për rrjedhojë, në përgjithësi bëjnë një përzgjedhje jo të mençur të portofolave gjatë ciklit të jetës.”*

36. Kthimet e ulëta mund të lindin nga disa probleme:

- *Marrje e tepruar e riskut* (kështu që, kthimet për një nivel të caktuar risku nuk janë të maksimizuara);
- *Shmangie e tepruar nga risku* (sidomos kur mundësitë e para të cilat ofrojnë kthime “të sigurta” apo të garantuara zgjidhen nga shumë individë, edhe pse këto alternativa mund të mos kenë realizuar një nivel të mjaftueshëm të ardhurash për pensionin pavarësisht sasive të mëdha të kontributeve);
- *Procese jo eficiente* (domethënë, kthime poshtë optimale për një nivel të caktuar risku);
- *Vëmendje e pamjaftueshme ndaj likuiditetit* (shih box-in);
- *Tregu bie pak përpara daljes në pension* (një rast i veçantë i riskut të likuiditetit)

Risku i likuiditetit në skemat me kontribute të përcaktuara

Risku i likuiditetit është një tjetër aspekt i riskut të investimeve që lidhet me disa skema pensionesh me kontribute të përcaktuara, domethënë, risku që investimet mund të mos

jenë aq likuide sa duhet për të përmbushur kërkesat që duhet të përmbushë skema për të paguar tepricat të anëtarët e tyre pa pasur humbje të papërballueshme. Ky mund të jetë problem sidomos për skemat me kontribute të përcaktuara duke qenë se anëtarët zakonisht i tërheqin pagesat që u takojnë me një shumë të vetme, ndonjëherë me fleksibilitet të konsiderueshëm sa i takon kohës së tërheqjes së këtyre pagesave.

Nuk ka pse të jetë problem i ndjeshëm atëherë kur skemat mbajnë aktive të cilat janë të tregtueshme në tregje të thella e likuide. Madje, kjo përbën një kërkesë ligjore në shumë vende, të cilat i ndalojnë investimet në instrumente jo likuide apo të cilat vendosin kufizime sasiore mbi përqindjen e portofolit që mund të investohet në instrumente “alternative” që nuk ofrohen në bursë (shih (OECD 2008b), (Stewart 2007) dhe (IOPS 2008c)).

Mirëpo, aty ku skemat kanë liri të konsiderueshme për të investuar në klasa aktivesh jo likuide apo në aktive që dalin më vonë se nuk janë likuide gjatë një krize financiare (për shembull, në prona tregtare), ekziston risku i mundshëm që skemat mund të pësojnë humbje të rënda gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre.

Për rrjedhojë, autoritetet mbikëqyrëse mund të vihen në kërkim të proceseve të menaxhimit të riskut për ta zgjidhur edhe këtë risk. Për shembull, në veçanti autoriteti australian e ka bërë prioritet të vetin këtë gjë gjatë kontrolleve në terren, gjatë krizës financiare të vitit 2008-2009.

37. E megjithatë, mbikëqyrja e riskut të investimit në skemat me kontribute të përcaktuara nuk është një detyrë e lehtë. Në rastin e fondeve të pensioneve me përfitime të përcaktuara, organet mbikëqyrëse përqendrohen kryesisht te risku i investimit përmes niveleve jo të mbuluara me fonde dhe mospërputhjes midis aktiveve dhe pasiveve. Mirëpo, risku i investimit,

në rastin e skemave me kontribute të përcaktuara, është më i vështirë për t'u matur, duke qenë se duhen mbajtur në konsideratë shpërndarjet e probabilitetit, jo të probabilitetit të arritjes së rezultatit të specifikuar (me përjashtim të rasteve kur rezultati është i planifikuar, gjë e rrallë kjo, dhe për më tepër e vështirë për t'u matur për skemat me kontribute të përcaktuara). Procesi ndërlikohet më tej në ato raste ku anëtarëve u ofrohet mundësia për ta zgjedhur fondin. Në këtë rast, organet mbikëqyrëse duhet të zgjedhin nëse duan të fokusohen vetëm në fondin e zgjedhur automatikisht, duke i lënë anëtarët e fondeve të tjera t'i menaxhojnë vetë risqet e tyre në bazë të informacionit të rregulluar mirë, apo të fokusohen te të gjitha fondet duke e kufizuar zgjedhjen apo duke u siguruar që anëtarëve t'u jepet këshillimi i duhur. Madje, në disa vende anglishtfolëse, ekzistenca e mundësisë që u jepet anëtarëve për t'i zgjedhur fondet përdoret për të justifikuar qasjen e distancuar edhe ndaj fondit me zgjedhje automatike, sidomos nëse një fond i tillë nuk është i detyrueshëm.

38. Në rastin e skemave me kontribute të përcaktuara, edhe pse organet mbikëqyrëse mund të jenë në gjendje ta kontrollojnë arritjen e rezultateve, deri në njëfarë shkalle (nëse ofrohen garanci, ose nëse specifikohet shprehimisht niveli i riskut të tolerueshëm) më shpesh vëmendja përqendrohet te mënyra se si i menaxhojnë fondet e pensioneve riskun e investimit dhe risqet e tjera, domethënë ato që kanë rëndësi janë faktorët dhe sistemet e përdorura. Në mbarë botën, shihen qartë katër qasje:

- Marrja e masave për t'u kujdesur që disiplina e tregut mundëson zgjedhjen e informuar të pjesëmarrësit dhe, për rrjedhojë, lejon konkurrencë të efektshme midis skemave dhe fondeve të pensioneve, në mënyrë që të stimulojë një praktikë të mirë të investimeve, të mbuluar me njohuritë e anëtarëve;

- Nxitja e planeve për të ndjekur praktikën më të

mirë në proceset administruese dhe menaxhimin e riskut që lidhet me investimet, në mënyrë që kujdestarët apo administratorët e skemës të marrin vendimet e duhura të mbështetura në informacione, të cilat e optimizojnë riskun dhe kthimin brendapërbrenda portofolave;

- Mbjajtja nën kontroll e sasisë së riskut në fond, përmes kontrollit të zbatimit të kufijve sasiore që vendosin aktet normative, udhëzuesit mbikëqyrës apo aktet e brendshme të fondeve sa i takon përbërjes së portofolit të fondit; ose
- Mbjajtja nën kontroll e zbulimit të anëtarëve ndaj riskut, duke sanksionuar dhe kontrolluar zbatimin e llojeve të specifikuara të modeleve të produkteve.

39. Këto qasje nuk e përjashtojnë njëra tjetrën dhe shumica e organeve mbikëqyrëse luajnë njëfarë roli në lidhje me secilën syresh, paçka se theksin e vendosin më shumë te disa e më pak te të tjerat. Kështu, pra, shumë vende u kërkojnë fondeve të pensioneve të përgatisin një pasqyrë zyrtare të parimeve të investimit dhe mund të kontrollojnë nëse ndiqen apo jo këto parime, edhe atëherë kur zbatohen kufizime minimale rregullatore apo mbikëqyrëse mbi përbërjen e portofolit. Shumica e vendeve vendosin disa kufizime sasiore edhe mbi portofolat e fondit, sidomos në lidhje me investimin në njësinë ekonomike që e financon fondin, por edhe për të siguruar diversifikimin e riskut, edhe atëherë kur nuk zbatohen kufizime mbi llojet e aktiveve. Më shpesh, organet mbikëqyrëse kërkojnë të mundësojnë vjeljen e përfitimeve nga konkurrenca e efektshme, aty ku është e mundur një gjë e tillë, edhe pse mund ta vendosin theksin te kufijtë sasiore, investimet e mira apo praktika e menaxhimit të riskut.

40. Në këtë pjesë të materialit, shikohet mbikëqyrja e:

- sistemeve të menaxhimit të riskut (duke

- përfshirë edhe strategjinë e investimit);
- kufizimeve sasiore;
- projektimit të produktit (fondet e ciklit të jetës);
- kufijve të riskut;
- garancive;
- normave të planifikuara të të ardhurave.

Sistemet e menaxhimit të riskut

41. Një mënyrë themelore për ta mbajtur në kontroll riskun e investimit është t'u kërkohet fondeve të pensioneve që të kenë vetë disa sisteme të caktuara të menaxhimit të riskut.¹ Po të kemi parasysh vendosjen e theksin te proceset dhe jo te rezultatet, kontrolli mbikëqyrës i sistemeve të menaxhimit të riskut të fondeve të pensioneve merr një rëndësi edhe më të madhe në rastin e mbikëqyrjes së sistemeve të pensioneve me kontribute të përcaktuara.

42. Këto sisteme të menaxhimit të riskut bëhen edhe më të rëndësishme duke qenë se legjislacioni për pensionet në shumë vende është rregulluar vitet e fundit, ku norma e "personit të matur" është kthyer në parimin themelor mbi të cilin ngrihen rregullimi dhe mbikëqyrja e investimeve të skemave të pensioneve. Sipas kësaj norme, organet mbikëqyrëse vlerësojnë nëse qasja që ndjek fondi për investimet përputhet me atë të një personi të matur (ose, në disa vende, të një eksperti të matur) që investon fonde në emër dhe për llogari të një personi tjetër. *Udhëzuesi i OECD-së për menaxhimin e aktiveve të fondeve të pensioneve* (OECD 2006) nënvizon se standardi i personit të matur përqendrohet te sjellja dhe procesi dhe jo te rezultatet, "duke kërkuar të garantojë që personat përgjegjës për administrimin e aktiveve të fondit të pensioneve ta bëjnë këtë administrim në mënyrë profesionale me synimin e vetëm për t'i sjellë përfitime fondit të pensioneve dhe anëtarëve të tij". Vëmendja e vendosur te procesi mund të mbulojë

¹Për hollësi, shih materialin e punës nr 11 të IOPS-së (IOPS 2009) dhe praktikat e mira të lidhura me menaxhimin e riskut (IOPS 2010 – pritet të dalë).

edhe eficienten e investimeve si edhe rrezikshmërinë e shpërndarjes së aktiveve.

43. Disa vende përcaktojnë kërkesa ligjore për personin e matur, më shumë se të tjerët. Për shembull, në Irlandë ka një kërkesë ligjore sipas së cilës shpërndarjet automatike të aktiveve të fondit² duhet të vërtetohen nga një aktuar si shpërndarje të matura, çka ka mandatar fondet e ciklit të jetës. Afrika e Jugut kërkon një certifikim aktuarial çdo tre vjet të skemave me kontribute të përcaktuara (edhe atëherë kur nuk kanë pasive aktuariale), për të cilat duhen vënë në dijeni organi rregullator, në mënyrë që ky të kontrollojë respektimin e kërkesave ligjore.³

44. Udhëzuesi i OECD-së (2006) nënvizon se *“për shkak të fokusit të procedura, standardi i personit të matur e vendos ndjeshëm theksin te aftësia e organeve drejtuese të fondit të pensionit për të marrë me kontratë asistencë të kualifikuar dhe për të vendosur sistemet dhe procedurat e duhura të kontrollit të brendshëm për të zbatuar dhe ndjekur me efektivitet procesin e menaxhimit të investimeve”*. Sistemet e menaxhimit të riskut që u kërkohet fondeve të pensioneve të shfrytëzojnë mund të përcaktohen me hollësi nga organet mbikëqyrëse, ose organi mbikëqyrës mund të japë orientime se cilin lloj sistemi të menaxhimit të riskut do të donte të shihte të zbatuar, duke ia lënë në dorë hollësitë e vënies në zbatim vetë fondit të pensionit.⁴ Krahas nënshtrimit të inspektimeve nga enti rregullator për të parë zbatimin e kërkesave ligjore, ky respektimi i

²Llogaritë personale të kursimit për pensionet stimulohen nga tatimet, janë vullnetare dhe organizohen në mënyrë individuale.

³Aty ku skemat me kontribute të përcaktuara të Afrikës së Jugut kanë pasive aktuariale, për shembull, sepse e paguajnë pensionin nga teprica e akumuluar, kërkesa është për vlerësim aktuarial. Në praktikë, aty ku skemat me kontribute të përcaktuara i ekuilibrojnë kthimet mbi investimet, këto skema duhet përsëri të përgatisin një vlerësim trevjeçar. Certifikimi aktuarial pritet të mbulojë nëse, sipas mendimit të aktuarit: aktivet dhe pasivet janë përputhur si duhet – që është në fakt një kërkesë për shumë forma të përdorimit të ciklit të jetës; aktivet janë të përshtatshme, duke pasur parasysh pasivet e fondit; Nëse norma e kthimit mbi investimet që i kreditohet llogarisë individuale të anëtarit është rregulluar, ky bindet se norma e kthimit nuk e vendos në rrezik qëndrueshmërinë financiare të fondit dhe se norma e kthimit është e arsyeshme në raport me kthimin bruto mbi investimet, që fiton fondi.

⁴Informacion të hollësishëm për këtë udhëzim mund të gjeni në (IOPS 2009).

kërkesave ligjore (të paktën në Australi) nxitet edhe duke përcaktuar që personat e besuar të jenë të mbrojtur ligjërisht vetëm nëse i kanë përmbushur standardet për investimet.

45. Krahas kërkesave të përgjithshme (në lidhje me mbikëqyrjen e administrimit, sistemet e kontrollit të brendshëm, kërkesat për raportimin e brendshëm dhe për auditin), sisteme të tilla të menaxhimit të riskut zakonisht përmbajnë masa specifike për trajtimin e riskut të investimit.⁵ E lidhur ngushtë me këtë është kërkesa për një politikë të plotë për investimet. Madje, udhëzuesi i OECD-së (2006) thekson edhe që *“vendosja dhe përdorimi i një politike të plotë për investimet të konsiderohet si një aspekt jetik i përmbushjes së standardit të personit të matur”*.

46. Shihet rëndom në shumë vende që u kërkohet fondeve të pensioneve të përgatisin një pasqyrë të parimeve të investimit (për shembull, kjo është kërkesë ligjore e Direktivës IORP të Bashkimit Evropian).⁶ Respektimi i këtyre parimeve mund të kontrollohet në kuadër të çdo regjimi inspektimi në terren, por, të paktën në Kenia kërkohet që kjo pasqyrë t'i përcillet për dijeni entit mbikëqyrës të paktën çdo pesë vjet, ndërsa në Xhamajka enti mbikëqyrës kërkon madje që ta miratojë këtë dokument.

47. Standardet e OECD-së (OECD 2006) japin orientime të hollësishme se çfarë duhet të përmbajë një strategji e plotë për investimet, duke përfshirë edhe elementet e mëposhtme:

- Objektivat e investimeve;
- Shpërndarjen e aktiveve;
- Diversifikimi;

⁵Udhëzimi që ka nxjerrë enti rregullator australian, APRA, jep një shembull të mirë (shih APRA 2006). Qarkorja “Superannuation Circular No. II.D.1” “Menaxhimi i investimeve dhe zgjedhja e investimeve” është 21 faqe e gjatë dhe ka një kombinim të standardeve operative që duhet të ndiqen dhe orientim sa u takon praktikave të mira, shkeljet e të cilave do të dilnin gjatë inspektimeve rregullatore.

⁶Direktiva Evropiane 2003/41/EC (Direktiva IORP) <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32003L0041:EN:HTML>

- Nevoja për likuiditet;
- Metodika e vlerësimit;
- Përdorimi dhe monitorimi i instrumenteve derivative;
- Plani për përputhjen e aktiveve me pasivet (kur duhet);
- Matja, monitorimi dhe krahasimi vlerësuar i ecurisë;
- Procedurat e kontrollit, duke përfshirë tolerancat për riskun / procedurat për monitorimin e riskut;
- Formatit dhe shpeshtësia e raportimit.

48. Udhëzuesi thekson se strategjia për investimet duhet të përputhet me dispozitat ligjore (parashikimi për personin e matur dhe kufizimet sasiore) dhe me objektivat e fondit (domethënë, me karakteristikat e pasiveve, maturimin e detyrimeve, nevojat për likuiditet, tolerancën për riskun, etj.) të paktën duke identifikuar shpërndarjet e aktiveve strategjike (domethënë, formulën e aktiveve afatgjate për kategoritë kryesore të investimeve), objektivat për ecurinë (dhe mënyrën si do të monitorohen dhe modifikohen këto objektiva), çdo vendim të këshillit në lidhje me shpërndarjen taktike të aktiveve, përzgjedhjen e letrave me vlerë dhe realizimin e tregtimit. Udhëzuesi thotë se duhet zgjidhur edhe çështja e përdorimit të menaxherëve të brendshëm apo të jashtëm të investimeve (ku, në rastin e fundit, kërkohet një kontratë për menaxhimin e investimeve) dhe e kostove të monitorimit të këtyre shërbimeve. Në veçanti, udhëzimi vëren se politika për investimet për programet e pensioneve në të cilat zgjedhjen e investimeve e bëjnë anëtarët duhet të sigurojnë që anëtarëve t'u ofrohet një shumëllojshmëri alternativash të duhura për investimet, dhe që anëtarët të kenë në dispozicion informacionin e nevojshëm për marrjen e vendimeve për investimet dhe se politika për investimet duhet t'i klasifikojë alternativat e investimeve në përputhje me riskun e investimit që mbajnë anëtarët.

49. Edhe pse kontrolli rregullator i respektimit të

udhëzuesve për menaxhimin e riskut dhe për investimet në përgjithësi është i orientuar nga proceset, mund të përdoret edhe informacioni i gjerësishëm që mbledhin entet mbikëqyrëse për shpërndarjet dhe kthimet e investimet. Kontrolli mbikëqyrës mund të informojë edhe vlerësimi krahasues i fondeve kundrejt njëri tjetrit për të siguruar informacion se kush nuk tregon të vërtetën dhe ka ecuri jo të mirë, edhe pse pak dëshmi ka se kjo bëhet në praktikë. Për shembull:

- Autoriteti mbikëqyrës në Poloni shkon edhe një hap më tej, në lidhje me këtë aspekt. Enti mbikëqyrës vlerëson me çmim skemën me ecurinë më të mirë çdo vit (pasi janë zbritur tarifat) me mendimin nga të gjithë anëtarët e rinj të sistemit (të detyrueshëm) të cilët nuk e kanë bërë ende zgjedhjen e tyre.⁷ Një shpërndarje e ngjashme e bazuar në performancë zbatohet në Meksikë prej vitit 2008 (shpërndarja automatike tek menaxheri i pensionit i cili jep kthimin neto më të lartë 36-mujor).
- Në Kili organi rregullator pret që kthimet neto të investimeve të bien nën një fashë të specifikuar rreth kthimit mesatar për pesë skemat.⁸
- Në Australi, organi mbikëqyrës mbështetet te shpërndarjet e investimeve të skemës kur shikon nëse është menaxhuar me efektivitet apo jo risku i likuiditetit.
- Në Izrael organi mbikëqyrës ka zhvilluar (me akademikët përkatës) treguesit e rrezikshmërisë së investimeve të skemave me kontribute të përcaktuara. Këto tregues, të cilët organi mbikëqyrës i publikon në hapësirën e vet në internet, kanë si synim edhe që të veprojnë si mjet vlerësues për menaxherët e

⁷ Kjo do të dukej se do të shpërblente fokusin te shpërblimi më shumë se te shmangia e riskut dhe, çka është interesante, Polonia është thajse i vetmi vend në Evropën Lindore ku investimi në klasat e aktiveve me më shumë risk është në maksimumin e nivelit që lejojnë kufizimet sasiore.

⁸ Kjo dekurajon mbi mesataren marrjen e riskut. Në realitet (dhe ka shumë të ngjarë kjo të jetë diçka e pashmangshme) janë parë sjelljet e llojit "kope".

riskut të skemave dhe si instrument për organin mbikëqyrës për të ndihmuar në vlerësimin e drejtimit të investimeve gjatë inspektimeve të veta.

Kufizimet sasiore për investimet⁹

50. Përkundër lëvizjes së përgjithshme globale në drejtim të rregullimit dhe përdorimit të rregullit të personit të matur, kufizimet sasiore për investimet e një lloji a tjetër zbatohen ende për fondet e pensione në shumë juridiksione. Madje, udhëzimi i OECD-së (OECD 2006) shpjegon se si duhet të përdoren këto kufizime dhe si mund të ndërthuren me rregullin e personit të matur duke qenë se këto dy rregulla nuk e përjashtojnë njëri tjetrin. Kufizimet e investimeve në vetvete nuk sigurojnë që një investim të jetë “i matur”. Për rrjedhojë, në shumicën e vendeve kufizimet sasiore dhe rregulli i personit të matur përdoren të ndërthurur dhe madje nuk shihen si rregulla që nuk përputhen me njëri tjetrin. Sidoqoftë, organet mbikëqyrëse që mbikëqyrin fondet me kontribute të përcaktuara duhet të shohin parë nëse është apo jo e përshtatshme qasja e ndjekur për investimet, edhe atëherë kur zbatohen më shumë kufizime sasiore.

51. Në shumicën e vendeve ka kufizime mbi investimet në punëdhënësin që paguan kontributet dhe kufizime mbi përdorimin që mund t’u bëhet kategorive të aktiveve jo likuide, siç janë instrumentet derivateve. Kufizimet mbi shpërndarjen nëpër kategoritë e aktiveve (të cilat janë thuajse njësoj në të gjithë Evropën Lindore dhe Amerikën Latine, por gjenden edhe në Nigeri dhe Kenia) parashikohen kryesisht në aktet ligjore dhe ato nënligjore të miratuara nga enti rregullator. Ato mund të mbulojnë mbajtjet e aktiveve të kategorive të ndryshme (për

shembull, kapital neto) që nuk tregtohen në tregje financiare likuide apo që emetohen jashtë vendit, së bashku me kufizimet mbi mbajtjet e aktiveve të një emetuesi të vetëm, për të siguruar diversifikimin.

52. Rrjedhimisht, shumë autoritete mbikëqyrëse kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar zbatimin e një qasjeje sasiore për mbajtjen në kontroll të riskut të investimit brenda skemave të pensioneve me kontribute të përcaktuara, duke kontrolluar që shpërndarjet e aktiveve të mos i shkelin kufizimet e shprehura në terma sasiore lidhur me kategoritë e ndryshme të aktiveve apo kufizimet mbi përqindjen e aktiveve që mund të mbahen pranë një emetuesi të vetëm (për të evituar përqendrimin e riskut).

53. Është relativisht e lehtë të mbikëqyret respektimi i kufizimeve sasiore përmes monitorimit të raporteve që dorëzojnë skemat, të cilët në shumicën e këtyre vendeve janë të pakta (për shembull, pesë skema në Kili) dhe për të arritur ndreqjen e problemeve përmes një procedure të zbatimit me forcë. Në realitet, shumica e skemave në këto vende i shpërndajnë aktivet mirë brenda shumicës së kufizimeve sasiore. Është më e vështirë në vendet që mbikëqyrin qindra, për të mos thënë mijëra, fonde; këto vende mbështeten më shumë te rregulli i personit të matur.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:

E. Shehi, R. Guri, A. Dervishi, K. Haxhi,
Dh. Hazbiu, J. Mele, R. Eltari, E. Kokona

⁹ Për më shumë hollësi lidhur me rregulloren sasiore shih (OECD 2010)

